




## AKTIVITETET KRYESORE TË ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE KORRIK 2024

### DOGANAT REALIZOJNE 105% PLANIN E TË ARDHURAVE NË KORRIK, 2.5 MILIARDE LEKË MË SHUMË SE KORRIKU I VITIT 2023

Administrata Doganore e mbylli muajin Korrik 2024 në masën **21,3 mld lekë** ose rreth **105%** e planit të të ardhurave. Krahasuar me muajin Korrik 2023 janë realizuar rreth **2,5 mld lekë** më shumë (25 mln € më shumë). Një rekord i veçantë kanë qenë zhdoganimet e mallrave të akcizës ku karburantet kanë arritur në sasinë **67,200 ton** ose rreth **6,000 ton** më shumë se në Korrik 2023, cigare rreth **300 ton** ose rreth **20 ton** më shumë se muaji Korrik 2023, kafe rreth **700 ton** ose **20 ton** më shumë se në Korrik 2023 dhe birrë **12,800 ton** ose rreth **1,500 ton** më shumë se në Korrik 2023.



### DREJTORI I DOGANAVE NË VLORË: MIKPRITJA DHE PËRGJEGJËSIA PROFESIONALE, KRYEFJALA E ÇDO PUNONJËSI TË ADMINISTRATËS DOGANORE

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, vizitoi **Degën Doganore Vlorë**. Ai falenderoi stafin për përkushtimin profesional gjatë këtij sezoni të ngarkuar, ndërsa kërkoi që mikpritja dhe përgjegjësia profesionale të jenë kryefjala çdo punonjësi të administratës doganore. Me hyrjen në pikun e sezonit, stafi i Degës Doganore Vlorë është në shërbim 24/7, duke përballur me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm numrin e madh të mjeteve dhe pasagjerëve në këtë portë të rëndësishme për turizmin në vendin tonë.



### DREJTORI I DOGANAVE VIZITË EDHE NË DOGANËN E HANIT TË HOTIT

Drejtori i Doganave, Genti Gazheli, vizitoi edhe Doganën e Hanit të Hotit, e cila ashtu si çdo pikë tjetër doganore në vend po përballet me një fluks të madh lëvizjesh të qytetarëve në të dy anët e kufirit. Ai falenderoi punonjësit që po e përballojnë me mjaft profesionalizëm ritmin e punës në pikun e sezonit, duke u shërbyer 24/24 qytetarëve dhe pushuesve që kalojnë përmes kësaj pike doganore.



### NJË NDALESË - NJË KONTROLL, NJË VIT NGA HYRJA NË FUQI E MARRËVESHJES NË PIKËN KUFITARE TË QAFË THANËS

Në pikën kufitare të Qafë Thanës, prej një viti po funksionon plotësisht **programi i ri kufitar "Një ndalesë - Një kontroll"**. Ofrimi i shërbimit për qytetarët dhe bizneset në të njëjtin sportel ku shërbejnë administratat e të dyja vendeve për kontrollin kufitar, doganor dhe të kontrollit ushqimor, ka sjellë **thjeshtimin e procedurave të kontrollit, përgjysmimin e kohës dhe rritjen e transparencës** së administratave përkatëse.



### DREJTORIA E LABORATORIT DOGANOR RIMERR STATUSIN E AKREDITIMIT

Drejtorja e Labororit Doganor ka rimarrë statusin e akreditimit, duke akredituar **84 tregues** analitikë. Akreditimi i mëparshëm përfshinte vetëm **38 tregues**. Prej 84 treguesve të akredituar, **49 janë analiza** që kryhen në artikuj hidrokarbure, **9 tregues janë për artikuj ushqimorë** (birrë, verë, pije alkoolike) dhe **26 tregues kryhen mbi fibra të përzierjeve të ndryshme**.



### SELEC VLERËSON ME ÇMIMIN E DYTË DOGANAT SHQIPTARE PËR BASHKËPUNIMIN ME DOGANAT TURKE NË LUFTËN KUNDËR TRAFIQEVE

Qendra për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore (SELEC) ka vlerësuar me çmimin e dytë Doganat Shqiptare në bashkëpunim me Doganat Turke për luftën kundër trafikeve. Sipas vendimit të Komitetit të SELEC dhe bazuar në procedurën e ndarjeve të çmimeve për Hetimet e Përbashkëta, në kuadër të bashkëpunimit brenda vendeve të SELEC, hetimi i përbashkët Shqipëri - Turqi ka fituar **çmimin e dytë**.



### BASHKËPUNIMI, DOGANAT SHQIPTARE, GUARDIA DI FINANZA DHE DOGANAT ITALIANE ZHVILLOJNË TAKIMIN TEKNIK TË RADHËS NË TIRANË DHE DURRËS

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit mes Administratave Doganore të Shqipërisë dhe Italisë dhe të Guardia di Finanza, nënshkruar në **4 Prill** në Tiranë, u zhvillua takimi teknik i radhës i programit të bashkëpunimit që do të vazhdojë për një vit. Programi përfshin misione shtesë në Shqipëri dhe Itali për aktivitete specifike trajnimit, vizita në infrastrukturën portuale të **Barit, Ankonës, Triestes dhe Durrësit**.



### MURIQAN, DREJTORI GAZHELI KËRKON SHËRBIM SA MË MIKPRITËS NGA PUNONJËSIT E DOGANËS NË ZEMËR TË SEZONIT TURISTIK

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli zhvilloi një vizitë në **pikën doganore të Muriqanit**, ku pa nga afër punën e punonjësve të kësaj dogane në zemër të sezonit turistik. Duke u shprehur mirënjohjen stafit për profesionalizmin në përballimin e fluksit të lartë të vizitorëve, ai ka kërkuar shërbim sa më mikpritës.



### DOGANA DIGJITALE

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës E-Albania. Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit. Vetëm gjatë muajit korrik 2024 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar **806 shërbime online**.

### KUJDES...

Për të gjitha blerjet online apo dërgesat postare mbi kufirin e pataksueshëm kryhet **deklarim doganor** nëpërmjet procedurës së **deklarimit të thjeshtuar**. Ky deklarim kryhet nga operatorët postarë dhe në shumicën e rasteve konsiderohet si shërbim i kryer nga këta të fundit. Çdo tarifë e arkëtuar për këtë shërbim apo për dërgimin e mallrave deri te pritësi nuk është pjesë e detyrimeve doganore të importit e për rrjedhojë nuk është përgjegjësi e autoriteteve doganore por e **operatorit postar**.



### A E DINI SE?

Lidhur me **blerjet online** dhe **dërgesat postare**:

Kufiri i pataksueshëm i vlerës së mallrave, të natyrës jo-tregtare (për përdorim personal apo familjar), të ardhura nga blerjet online, apo si dërgesa postare nga individë jashtë territorit shqiptar është:

- **22 Euro** - për blerjet online (këtu bëhet fjalë vetëm për vlerën e mallrave të faturuar pa përfshirë shpenzimet e transportit apo tarifën postare)
- **45 Euro** - për dërgesat postare (këtu bëhet fjalë për vlerën e deklaruar në nisje nga dërguesi i mallrave pa përfshirë shpenzimet e transportit apo tarifën postare).

Për mallrat me vlerë mbi kufijtë e sipërpërmendur, detyrimisht duhet të paguhet detyrimet doganore të importit. Në përcaktimin e këtyre detyrimeve përfshihet krahas vlerës së mallit edhe shpenzimet e transportit.

